



PRISHTINA

	NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.
Nr. <u>08/761</u> No.	Data <u>15.05</u> 20 <u>23</u> Date
PRISHTINË/A	



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISHTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit 04/L-111 për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit 05/L-009 për Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-087, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, konkretisht nenin 5, si dhe bazuar në Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) "Stacioni i Autobusëve", në mbledhjen e mbajtur me datë 12.05.2023, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

(Mbi anulimin e konkursit të shpallur me datë 24.01.2023 për përzgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe rishpalljen e konkursit)

- I. Anulohet konkursi për përzgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A Prishtinë, i datës 24.01.2023.
- II. Shpallet konkursi publik për përzgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A Prishtinë.
- III. Konkursi për përzgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A Prishtinë, sipas pikës 2 të këtij vendimi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të shpalljes së Konkursit.
- IV. Kushtet dhe kriteret e konkursit për përzgjedhjen e 4 anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A Prishtinë, bazohen në Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë, Viti III/Nr.31/15 Qershor 2008), dhe plotësim/ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 16.2 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të plotësim/ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009, Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", Sh.A, më 14.11.2022 kishte shpallur Konkurs Publik për zgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".



Me vendimin nr. 02/81 i datës 23.01.2023, ky konkurs ishte anuluar si rezultat i mungesës së dokumenteve të kandidatëve, ngjarje e cila është në fazë hetimore. Me po të njëjtin vendim, konkursi është rishpallur më 24.01.2023, ku gjithsej 28 kandidatë kishin plotësuar kriteret për t'u intervistuar, katër (4) prej të cilëve kishin arritur të grumbullonin më së shumti pikë.

Që nga koha e ri-shpalljes së konkursit e deri më tani, kanë kaluar afërsisht pesë (5) muaj, gjatë të cilëve ka ndryshuar edhe përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, fakt i cili ka ndikuar në mos-nxjerrjen e një vendimi me listën definitive të kandidatëve me më së shumti pikë.

Për të arritur deri në vendosjen si në dispozitivin e këtij vendimi, Komisioni i Aksionarëve Komunal kanë marrë për bazë shkeljet që janë bërë gjatë procedurës së përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Pasi Aksionarët kanë analizuar në detaje tërë procedurën, kanë gjetur se njëra prej kandidateve të vlerësuar me numrin më të madh të pikëve, nuk i plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në konkursin publik të datës 24.01.2023 dhe atë kushtin II të konkursit, ku është përcaktuar se: Drejtorët e Bordit nuk duhet të jenë në pozita menaxheriale të ndërmarrjes së paku pesë (5) vitet e fundit.

Në bazë të të gjeturave është parë se njëra prej kandidateve, gjatë periudhës së cekur më lartë (pesë vjeçare) ka ushtruar funksionin e Auditorit të Brendshëm të Ndërmarrjes, e rrjedhimisht i bie që ka pasur të hyra nga Ndërmarrja, që konsiston edhe në shkeljen tjetër të kushteve të Konkursit Publik të datës 24.01.2023.

Andaj, për qëllime të transparencës, të gjithë Drejtorët e Bordit duhet t'i plotësojnë në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara si në shpallje dhe se mos përmbushja e të gjitha kriterëve konsiston në procedurë jo të rregullt të emërimit të Drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes. Pra, mos përmbushja e kushteve dhe kriteve kryesore konsiston në shkelje absolute, gjë që ka shtyrë Aksionarët në vendosjen si në dispozitivin e këtij vendimi.

Komisioni i Komunal i Aksionarëve

1. Florent Maliqi
2. Donjeta Dragusha
3. Amir Simnica

